



01Korrik,2009

## **Travelport GDS, i ofron linjes ajrore low cost-Norwegian lidhjen direkte me sistemin Galileo.**

Travelport GDS, nje nga liderat boteror te Sistemit Global te Shperndarjes ka deklaruar detajet e marreveshjes me linjen ajrore Skandinave low-cost- Norwegian. Sipas kesaj marreveshje e gjithë permbajtja e linjes low cost-Norwegian do te ofrohet nepermjet sistemit te rezervimit Galileo, duke I krijuar ne kete menyre agjenteve te udhetimit mundesine e perzgjedhjes se opsioneve shtese si bagazhet, perzgjedhjen e vendeve ne avion si dhe rritjen e efikasitetit pergjate procesit te rezervimit.

Travelporti konfirmoi se ky produkt vjen si rezultat I rritjes se rendesise se sektorit ajror low-cost dhe kerkeses se agjenteve te udhetimit per te kanalizuar permbajtjen/sherbimin low-cost nepermjet Sistemeve Globale te Shperndarjes, GDS. Deri ne 60 linja ajrore low-cost kane shprehur interesin e lidhjes me Travelportin, ku gjate javeve te ardheshme do te realizohen marreveshjet e reja me keto kompani.

Kjo zgjidhje, e cila po perdoret gjeresisht ne Evrope nga agjensite e udhetimit, u prezantua vjet nga kompania ajrore low-cost easyJet. Qe nga ajo dite agjentet e udhetimit kane permiresuar shume produktivitetin dhe efikasitetin krahasuar me rezervimet e realizuara nepermjet web-it, qe faktikisht kerkojne me shume kohe. Ne kontrast me websitet e linjave ajrore agjentet kane mundesine qe nepermjet sistemit te rezervimit Galileo ne te njejten PNR(Passenger Name Record) te kombinojne rezervime te linjave low-cost me linjat tradicionale psh ne nisje me Norwegian dhe ne kthim me British Airways.

Benifiti tjetër për agjentet e udhetimit është gjithashtu automatizimi i informacionit të financës në sistemin back office.

Matthew Hall, ZV/Presidenti i Departamentit të Zhvillimit të Biznesit Ajror për Travelportin komentoi: "Ne situatën e sotme ekonomike, shumë sfiduese dhe ndryshuese, ne po shikojmë gjithnjë e më shumë biznese që perpiqen të menaxhojnë sa më mirë shpenzimet e udhetimit dhe kjo teknologji u jep agjenteve mundesine e krahasimit të çmimeve të një linje low-cost me ato të linjës tradicionale. Implementimi i suksesshem i linjave low-cost në Evropë tregon që rezervimi nepermjet sistemeve GDS i një fluturimi low-cost është më të vertete shumë me i

shpejte se cdo metode e meparshme e perdorur nga agjentet e udhetimeve. Jemi shume te kenaqur qe kemi mundesine ti ofrojme te njejtin efikasitet, fluturimeve te linjes ajrore Norwegian”.

Duke gene mjaft e sukseshme ne Evrope per te gjithë perdoruesit e sistemit Galileo, shume shpejt kjo zgjidhje do te lancohet dhe ne Lindjen e Mesme.

### Rreth Travelportit

Travelporti eshte nje nga liderat boteror qe u ofron sherbime te larmishme kompanive qe operojne ne fushen e Turizmit. Travelporti si nje grupim kompanish te markave te ndryshme perfshin: GDS, sistemet Globale te Shperndarjes, sistemet e Worldspan & Galileo; GTA- Gullver Travel Association nje lider global i sherbimit hotelier dhe sherbimeve ajrore; sherbimet e IT dhe softwareve si dhe analiza te dhenash per linja te ndryshme ajrore. Me te ardhura prej \$2.5 miliard dollar, Travelporti operon ne me shume se 160 shtete me 5500 punonjes. Travelporti ka ne pronesi rreth 48% te Orbitz, nje kompani udhetimi online.

Travelporti eshte nje kompani private ne pronesi te grupit Blackstone, kompanise Technology Crossover Ventures-TCV, dhe vete menaxhimit te Travelportit.

### Rreth Norwegian,

Qe ne fluturimin e pare ne Shtator 2002 linja ajrore low cost- Norwegian ka transportuar me shume se 10Million pasagjere ne vit duke operuar ne me shume se 80 destinacione dhe 180 itinerare ne Skandinavi, Evrope dhe Lindjen e Mesme.

Norwegian.com zoteron nje flote prej 45 avionesh vecanerisht Boeing 737-300 dhe 737-800, gjithashtu dhe markat e reja te Boeing 737.800 qe kompania do ti zoteroje pergjate periudhes Gusht 09 deri ne 2015.